FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 174

Tiranë – E hënë, 29 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 25.9.2025	Për shkëmbimin e pronës me emërtimin "Njësia e Sigurisë Publike Shkodër", në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pasurinë nr. 19/10, në zonën kadastrale 3168, Shkodër, në pronësi të Bashkisë Shkodër.....	21915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 25.9.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi, për projektin 'Përforcimi i pallatit 1300', Bashkia Vlorë".....	21921
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 25.9.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 81, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese".....	21922
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.9.2025	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k.....	21924
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 25.9.2025	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Njësinë Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë, nga shoqëria "Met Invest" sh.p.k.....	21925

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 25.9.2025	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin e mundësimit të turizmit dhe infrastrukturës, miratuar me vendimin nr. 883, datë 12.11.2020, të Këshillit të Ministrave.....	21928
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 25.9.2025	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Mira Kapisyzi.....	21930
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 25.9.2025	Për delegimin e kompetencave.....	21930
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 914, datë 22.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	21930
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 915, datë 22.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	21933
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 916, datë 22.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Serbisë.....	21934
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 917, datë 23.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	21934
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 60/17, datë 22.9.2025	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit, rrugët paralele me hekurudhën nga kthesa e Kamzës deri tek stacioni hekurudhor në Kashar – loti 1.....	21935
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Tabeko Jaupaj.....	21940

VENDIM
Nr. 530, datë 25.9.2025

PËR SHKËMBIMIN E PRONËS ME EMËRTIMIN "NJËSIA E SIGURISË PUBLIKE SHKODËR", NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, ME PASURINË NR. 19/10, NË ZONËN KADASTRALE 3168, SHKODËR, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëmbimin e pronës me emërtimin "Njësia e sigurisë publike Shkodër", me sipërfaqe truall 25 590 (njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) m^2, dhe sipërfaqe ndërtimore 1 286 m^2 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) m^2, në zonën kadastrale 8592, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas formularit të përditësimit dhe planit të rilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, me pasurinë nr. 19/10, zona kadastrale 3168, Shkodër, me sipërfaqe 23 149 (njëzet e tre mijë e njëqind e dyzet e nëntë) m^2, në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme", të ndryshuar, hiqet prona me emërtimin "Njësia e sigurisë publike Shkodër" dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, me qëllim ushtrimin e funksioneve social-kulturore dhe sportive.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, hiqet pasuria nr. 19/10, në zonën kadastrale 3168, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme", të ndryshuar, me qëllim ushtrimin e funksioneve të rendit dhe sigurisë publike.

4. Shkëmbimi i këtyre pronave kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e tyre.

5. Shkëmbimi realizohet nëpërmjet kontratës së shkëmbimit, e cila lidhet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Shkodër, pasi të jetë bërë akomodimi i përshtatshëm i "Njësisë së sigurisë publike Shkodër" dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për ushtrimin e funksioneve administrative të kësaj njësie.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET **DATË 01.09.2025** **QËLLIMI: TRANSFERIM**

VENDNDODHJA: BASHKIA SHKODËR DVASHK/ZVASHK SHKODËR ZONA KADASTRALE: 8592 NUMRI PASURISË: 10/241; 10/128; 10/129; 10/130; 10/131; 10/132; 10/133; 10/134 INDEX HARTE: SH; H-9,10; I-10

TË DHËNA TE PASURISË:

LLOJI PASURISË: TRUALL SIP. TRUALL: 25590.63 m² SIPËRFAQJA GJURMËS NDËRTIMIT TË OBJEKTIT: 1229.35 m² NUMRI KATEVE: ___ NUMRI PEMËVE_____

X,Y 460187.935 4660831.123

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

461113.335 4660831.123 X,Y



X,Y 460187.935 4660220.723

SHKALLA 1:2500

461113.335 4660220.723 X,Y



SHPJEGUES

KUFIRI I PRONËS SIPAS FAKTIT

GJURMË NDËRTIMI

SIPËRFAQJA TOTALE E TRUALLIT 25 590 M2

SIPËRFAQE TOTALE NDËRTESASH 1 286 M2

N1 - SIPËRFAQJA 348 M2
N2 - SIPËRFAQJA 216 M2
N3 - SIPËRFAQJA 63 M2
N4 - SIPËRFAQJA 19 M2
N5 - SIPËRFAQJA 240 M2
N6 - SIPËRFAQJA 64 M2
N7 - SIPËRFAQJA 336 M2

NDËRTESA E PAS. 10/132, RRËNOJË E PAPËRFSHIRË NË PËRDITËSIMIN E VKM. (nr. rendor 8 te formulari i VKM 840/2015)

FOTOGRAFIMI SATELITOR

NR.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARËT	ID/NIPT	SHENIME TË REALIZUESIT
1	VERI			10/25; 10/21;		
2	LINDJE			10/25;		
3	JUG			10/10; 10/12;		
4	PERËNDIM			10/124; 10/125;		

DREJTORIA ASETEVE E KADASTRES URBANE

SPECIALISTI : ARJAN VASIJA

REALIZOI PËR ASHK:

SPECIALISTI:

NËNSHKRIMI_____

KONFIRMOI: DREJTOR/PËRGJEGJËS

NËNSHKRIMI/VULA_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:_____

Kode per teknologjine e matjeve T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:_____

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT:

MINISTRIA E BRENDSHME

PËRFAQËSUESI I INSTITUCIONIT QENDROR: ABSHKIA SHKODER

ZV/KRYTARI
ALBAN PREKA

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia:Shkodër

Identifikoi pronën: **Arjan VASIJA** **Arban GJOKA** Specialist
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi:
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Alban PREKA** Zv.Kryetar me vendim delegimi
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip. Truall (m2)	Ndërtesë (m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
	8592	10/241 10/128 10/129 10/130 10/131 10/132 10/133 10/134	Truall	Hapësire Rekreacioni	25590	25590	1286	Social Kulturore Sportive	Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder		
			N1				348	Godina e Komandes				
			N2				216	Fjetore				
			N3				63	Tualet				
			N4				19	Of/Roje				
			N5				240	Park Automjetesh				
			N6				64	Oficinë				
			N7				336	Mensa				
			Totali Truall + ndertese		**25590**	**25590**	**1286**					

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për prona me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3168006134
(Nga 3168001146, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3168, Lloji i Pasurisë: SHESH, Nr. i Pasurisë: 19/10, Sipërfaqja Totale 23149 m2, (Nga të Cilat Truall 1176.55 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-64-210-B, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia RRENC, Rruga RRENC, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 4332, Dt. 05/03/2025), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA SHKODER , Nr. Identifikimi/NIPT K36813001H, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia SHKODER, Rruga 13 DHJETORI, Ndërtesa Nr. ___, SH/K ___, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 4332, Datë: 05/03/2025
Regjistruar: Nr. 737, Datë: 05/04/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __, Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00000579	18/01/2024	Përdorim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	274	02/05/2019	20 vite	Drejtoria Përgjithshme e Rezervave Mat.të Shtetit	J72415001A

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera , Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi Nr. 274 , Datë: 02/05/2019
Regjistruar: Nr. 0579 , Datë: 12/07/2021
Përshkrimi: Siperfaqja e gjurmeve te ndertimit eshte 2353.1m2 (Objektet e Rrenuara)

DREJTORI
Eglantina Frroku

Data e lëshimit 17/09/2025

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE : 3168006134 **KODI UNIK : 3168006134**

PASURISË : 19 / 10 **INDEX I HARTËS :**

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

SHPJEGUES
PARCELA
NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)

VENDIM
Nr. 532, datë 25.9.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "LEJE RIKONSTRUKSIONI TË NDËRTESËS SË DËMTUAR, PA SHTIM APO NDRYSHIM VOLUMI, PËR PROJEKTIN 'PËRFORCIMI I PALLATIT 1300', BASHKIA VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi, për projektin 'Përforcimi i pallatit 1300', Bashkia Vlorë".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh përballohet nga Bashkia Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Vlorë, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Vlorë, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "LEJE RIKONSTRUKSIONI TË NDËRTESËS SË DËMTUAR, PA SHTIM APO NDRYSHIM VOLUMI PËR PROJEKTIN, 'PËRFORCIMI I PALLATIT 1300', BASHKIA VLORË"

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m²	Ndërtesë m²	Adresa	Sipërfaqe trualli për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/1	Truall	72	197	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00	4,843,852.00	5,533,752.00	
2	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/2	Truall	72	198	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00			
Vlera totale												689,900.00	4,843,852.00	**5,533,752.00**	

VENDIM
Nr. 533, datë 25.9.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 81, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat, që i bashkëlidhen vendimit nr. 81, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Nr Pikes	X	Y
1	480401.1488	4581032.782
2	480408.7791	4581038.359
3	480409.5024	4581039.965
4	480434.4565	4581028.722
5	480474.7757	4581011.023
6	480485.2577	4581011.686
7	480491.6931	4581010.826
8	480496.498	4581010.391
9	480504.8641	4581009.345
10	480514.0361	4581008.197
11	480523.623	4581007.161
12	480529.387	4581005.343
13	480536.0595	4581004.209
14	480541.1446	4581003.002
15	480543.4868	4580994.286
16	480551.8083	4580994.382
17	480552.3887	4580944.072
18	480558.553	4580938.049
19	480638.9052	4580938.979
20	480657.3151	4580922.451
21	480661.5753	4580878.222
22	480657.5313	4580877.833
23	480657.0258	4580877.784
24	480655.5092	4580877.638
25	480653.9927	4580877.492
26	480653.4872	4580877.443
27	480651.4652	4580877.248
28	480649.4432	4580877.054
29	480645.1829	4580921.282
30	480639.0463	4580926.791
31	480471.8211	4580924.856
32	480471.6466	4580924.851
33	480471.4724	4580924.84
34	480471.2986	4580924.822
35	480471.1256	4580924.799
36	480470.9535	4580924.77
37	480470.7826	4580924.734
38	480470.6129	4580924.693
39	480470.4448	4580924.646
40	480470.2785	4580924.593
41	480470.1141	4580924.534
42	480469.9519	4580924.47
43	480469.792	4580924.4
44	480469.6346	4580924.324
45	480469.48	4580924.243
46	480469.3283	4580924.157
47	480469.1797	4580924.065
48	480469.0344	4580923.968
49	480468.8926	4580923.867
50	480468.7544	4580923.76
51	480468.62	4580923.649
52	480468.4896	4580923.533
53	480468.3633	4580923.412
54	480468.2413	4580923.287
55	480468.1237	4580923.158
56	480468.0107	4580923.025
57	480467.9025	4580922.888
58	480467.799	4580922.747
59	480467.7005	4580922.603
60	480467.6072	4580922.456
61	480467.519	4580922.305
62	480467.4361	4580922.151
63	480467.3587	4580921.995
64	480467.2867	4580921.836
65	480467.2204	4580921.675
66	480467.1597	4580921.511
67	480467.1048	4580921.345
68	480467.0557	4580921.178
69	480467.0125	4580921.008
70	480466.9752	4580920.838
71	480466.9439	4580920.666
72	480466.9185	4580920.493
73	480466.8993	4580920.32
74	480466.8861	4580920.146
75	480466.879	4580919.971
76	480466.8779	4580919.797
77	480467.9642	4580825.946
78	480473.0229	4580821.003
79	480474.3402	4580821.018
80	480475.799	4580815.476
81	480476.8873	4580811.342
82	480476.8873	4580811.342
83	480477.5389	4580808.866
84	480340.6563	4580807.287
85	480313.5612	4580806.975
86	480311.1911	4580819.136
87	480316.1406	4580819.194
88	480322.1641	4580825.358
89	480320.3661	4580981.224
90	480332.5537	4580981.364
91	480346.6541	4580989.046
92	480361.1102	4580996.402
93	480361.5365	4580999.933
94	480369.0226	4581001.596
95	480381.8246	4581012.329
96	480395.9601	4581027.392

VENDIM
Nr. 534, datë 25.9.2025

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "IDI 2005" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: shoqëria "IDI 2005" sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: K61507510N;

c) Tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 8.8 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;

g) Shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

KOORDINATAT NË KRRGJSH PËR "IDI 2005" 8.8 MW					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
P1	451416.545	4510649.759	P5	451494.929	4510457.817
P2	451514.709	4510734.979	P6	451846.969	4510742.033
P3	451403.909	4510870.472	P7	451729.451	4510889.864
P4	451302.325	4510784.825	P8	451381.021	4510596.427



VENDIM
Nr. 535, datë 25.9.2025

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR ERSEKË, BASHKIA KOLONJË, QARKU KORÇË, NGA SHOQËRIA "MET INVEST" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në Njësinë Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë, nga shoqëria "Met Invest" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: shoqëria "Met Invest" sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: L81310039M;

c) Tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 30 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Njësinë Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;

g) Shoqëria "Met Invest" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "Met Invest" sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "Met Invest" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

PIKAT	UTM(E, N)		GK(E,N)		KRGJSH(E, N)	
1	474391.54	4465376.69	4474512.45	4467293.68	559352.20	4467354.12
2	474410.62	4465391.42	4474531.54	4467308.41	559371.12	4467369.06
3	474428.66	4465395.76	4474549.59	4467312.75	559389.13	4467373.61
4	474490.95	4465394.25	4474611.90	4467311.24	559451.45	4467372.80
5	474534.86	4465368.54	4474655.83	4467285.52	559495.67	4467347.58
6	474563.36	4465329.89	4474684.34	4467246.86	559524.62	4467309.24
7	474610.19	4465319.59	4474731.19	4467236.56	559571.58	4467299.47
8	474646.05	4465329.37	4474767.07	4467246.34	559607.34	4467309.65
9	474646.95	4465329.05	4474767.97	4467246.02	559608.25	4467309.35
10	474658.80	4465342.03	4474779.82	4467259.00	559619.96	4467322.46
11	474666.66	4465349.17	4474787.68	4467266.14	559627.74	4467329.69
12	474669.45	4465344.25	4474790.48	4467261.22	559630.59	4467324.80
13	474660.67	4465335.97	4474781.69	4467252.94	559621.90	4467316.42
14	474677.23	4465300.65	4474798.26	4467217.60	559638.86	4467281.27
15	474673.59	4465286.88	4474794.62	4467203.83	559635.38	4467267.45
16	474804.37	4465283.61	4474925.45	4467200.56	559766.24	4467265.67
17	474806.82	4465253.64	4474927.90	4467170.58	559769.03	4467235.71
18	474812.37	4465272.17	4474933.46	4467189.11	559774.37	4467254.31
19	474811.48	4465276.85	4474932.57	4467193.79	559773.43	4467258.98
20	474813.29	4465321.76	4474934.37	4467238.72	559774.73	4467303.93
21	474855.25	4465300.17	4474976.35	4467217.13	559816.96	4467282.81
22	474916.24	4465363.66	4475037.37	4467280.64	559877.25	4467347.01
23	474911.33	4465402.22	4475032.45	4467319.22	559871.90	4467385.53
24	474932.07	4465418.61	4475053.20	4467335.61	559892.46	4467402.16
25	474956.40	4465425.78	4475077.55	4467342.79	559916.72	4467409.61
26	474972.72	4465432.45	4475093.87	4467349.46	559932.97	4467416.46
27	474989.54	4465425.60	4475110.70	4467342.60	559949.88	4467409.80
28	474998.44	4465401.83	4475119.60	4467318.83	559959.04	4467386.13
29	475017.22	4465414.53	4475138.39	4467331.53	559977.69	4467399.04
30	475023.48	4465407.55	4475144.65	4467324.55	559984.04	4467392.12
31	475091.78	4465454.55	4475212.98	4467371.56	560051.83	4467439.91
32	475121.12	4465467.79	4475242.33	4467384.82	560081.02	4467453.50
33	475218.00	4465494.11	4475339.25	4467411.15	560177.64	4467480.92
34	475230.15	4465642.25	4475351.41	4467559.35	560188.13	4467629.26
35	475222.17	4465645.08	4475343.42	4467562.18	560180.11	4467631.99
36	475187.16	4465663.11	4475308.39	4467580.21	560144.88	4467649.64
37	475158.01	4465659.46	4475279.23	4467576.56	560115.76	4467645.65
38	475113.77	4465646.66	4475234.98	4467563.76	560071.65	4467632.35
39	475075.45	4465642.26	4475196.64	4467559.35	560033.37	4467627.51
40	475052.52	4465644.16	4475173.70	4467561.26	560010.41	4467629.16
41	475034.44	4465653.05	4475155.61	4467570.15	559992.22	4467637.84
42	474994.85	4465660.93	4475116.01	4467578.03	559952.53	4467645.28
43	474955.34	4465657.27	4475076.48	4467574.37	559913.04	4467641.17
44	474930.79	4465662.90	4475051.93	4467580.00	559888.42	4467646.53
45	474889.45	4465665.96	4475010.56	4467583.06	559847.03	4467649.12
46	474789.24	4465692.13	4474910.31	4467609.24	559746.49	4467674.16

PIKAT	UTM(E, N)		GK(E,N)		KRGJSH(E, N)	
47	474757.98	4465689.74	4474879.04	4467606.85	559715.24	4467671.42
48	474742.97	4465700.25	4474864.03	4467617.37	559700.11	4467681.77
49	474723.64	4465704.55	4474844.69	4467621.67	559680.72	4467685.85
50	474702.08	4465701.73	4474823.12	4467618.84	559659.18	4467682.78
51	474678.67	4465704.83	4474799.70	4467621.95	559635.74	4467685.62
52	474650.35	4465718.02	4474771.37	4467635.14	559607.25	4467698.49
53	474623.13	4465728.00	4474744.14	4467645.12	559579.92	4467708.17
54	474611.37	4465729.09	4474732.37	4467646.22	559568.13	4467709.13
55	474592.49	4465743.40	4474713.49	4467660.54	559549.09	4467723.24
56	474576.37	4465751.63	4474697.36	4467668.77	559532.87	4467731.29
57	474554.09	4465760.67	4474675.07	4467677.82	559510.47	4467740.08
58	474538.43	4465764.50	4474659.40	4467681.65	559494.77	4467743.73
59	474517.57	4465783.63	4474638.54	4467700.78	559473.68	4467762.62
60	474485.74	4465809.45	4474606.69	4467726.61	559441.55	4467788.10
61	474465.49	4465813.35	4474586.43	4467730.52	559421.24	4467791.78
62	474455.81	4465818.93	4474576.75	4467736.09	559411.50	4467797.24
63	474435.49	4465823.58	4474556.43	4467740.75	559391.12	4467801.67
64	474413.96	4465824.62	4474534.89	4467741.78	559369.57	4467802.46
65	474390.30	4465833.97	4474511.21	4467751.15	559345.79	4467811.55
66	474372.98	4465837.07	4474493.89	4467754.25	559328.43	4467814.46
67	474342.72	4465839.43	4474463.62	4467756.61	559298.14	4467816.48
68	474317.30	4465838.13	4474438.18	4467755.30	559272.72	4467814.88
69	474313.62	4465837.94	4474434.50	4467755.11	559269.04	4467814.65
70	474296.49	4465837.55	4474417.37	4467754.73	559251.91	4467814.08
71	474260.69	4465847.56	4474381.55	4467764.74	559215.99	4467823.68
72	474224.51	4465847.92	4474345.36	4467765.10	559179.79	4467823.63
73	474268.87	4465757.07	4474389.73	4467674.21	559225.19	4467733.25
74	474274.34	4465738.84	4474395.20	4467655.98	559230.87	4467715.08
75	474287.66	4465719.65	4474408.53	4467636.77	559244.41	4467696.02
76	474330.65	4465630.65	4474451.54	4467547.73	559288.42	4467607.48
77	474391.47	4465541.91	4474512.38	4467458.96	559350.26	4467519.40



VENDIM
Nr. 537, datë 25.9.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM LETRASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROGRAMIN E MUNDËSIMIT TË TURIZMIT DHE INFRASTRUKTURËS, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 883, DATË 12.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin e mundësimit të turizmit dhe infrastrukturës, miratuar me vendimin nr. 883 datë 12.11.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 3822 Prot. Tiranë, më 21.3.2024

Lënda: Marrëveshja e Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës" miratuar me VKM. nr.883, datë 12.11.2020.

BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Rruga "Abdi Toptani" Ndërtesa Drin, Kati 4, Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

I referohem Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës". Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje Granti, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

-shtyrjen deri më 13.12.2027, të afatit të parashikuar sipas nenit 2.02 të Marrëveshjes së Grantit.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës.

Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit të palës shqiptare për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin METE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE

Shqipëri; Web: www.financa.gov.al

Logo

Banka Evropiane

për Rindërtim dhe Zhvillim

Drejtuar: SH.T. Petrit Malaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave, Blv. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

16 prill 2025

I nderuar Ministër Malaj,

Lënda: Projekti për Infrastrukturën dhe Turizmin në Shqipëri-data e Disponueshmërisë së Grantit

I referohemi shkresës së datës 21 mars 2024, me numër protokolli 3822, në lidhje me datën e disponueshmërisë të Marrëveshjes së Grantit, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 883, datë 12 nëntor 2020.

Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka miratuar zgjatjen e Datës të Disponueshmërisë së Grantit, deri më 27 dhjetor 2027, në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.02 (b) të Marrëveshjes së Grantit.

Dëshirojmë të përfitojmë nga rasti t'iu falënderojmë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme. Shprehim kënaqësinë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe garantimin e zbatimit të suksesshëm të këtij projekti të rëndësishëm.

Me respekt,

/Nënshkrimi/

Ekaterina Solovova
Drejtuese e BERZH-it për Shqipërinë

Zyra Rezidente në Shqipëri, Rruga "Abdi Toptani" Torre Drin Kati i Katërt, Tiranë, Shqipëri
Tel: ˜355 4 2232 898; +355 4 2235 204 Faks: +355 4 2230580

VENDIM
Nr. 538, datë 25.9.2025

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. MIRA KAPISYZI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Mira Kapisyzi, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 1, datë 25.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Mjedisit.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31 dhjetor 2025.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
4. Urdhri nr. 1, datë 6.1.2025, "Për delegimin e kompetencave", të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

URDHËR
Nr. 914, datë 22.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ**:**

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e

thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe e ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Bilje*	
Osjecko-Baranjska	Donji Miholjac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Jagodnjak*	
Osjecko-Baranjska	**Kneževi Vinogradi***	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Vukovarsko-Srijemska	Gradište*	
Vukovarsko-Srijemska	Stari Jankovci*	
Vukovarsko-Srijemska	Trpinja*	
Vukovarsko-Srijemska	Županja*	
Vukovarsko-Srijemska	Otok*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 907, datë 19.9.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 915, datë 22.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Castilla - La Mancha	TOLEDO	OROPESA*
Extremadura	Badajoz	Azuaga*
Andalucía	Huelva	Valverde del Camino (Andevalo Oriental)*
Castilla - La Mancha	Guadalajara	Guadalajara*
Castilla y León	**Valladolid**	**Olmedo***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Urdhri nr. 869, datë 9.9.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të

informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24- orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 916, datë 22.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SERBISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nga i gjithë shteti i Serbisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 917, datë 23.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Warmińsko-Mazurskie	**Iława**	**Susz***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

KËRKESË
Nr. 60/17, datë 22.9.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit, rrugët paralele me hekurudhën nga kthesa e Kamzës deri tek stacioni hekurudhor në Kashar – loti 1".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake shpronësimi, 1,634,311 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë, bazuar në vendimin nr. 89 të Këshillit të Ministrave, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "truall", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë, të cilët preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,634,311 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RRUGËT PARALELE ME HEKURUDHËN NGA KTHESA E KAMZËS DERI TEK STACIONI HEKURUDHOR NË KASHAR – LOTI 1"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												Shënime (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë)
														TRUALL			NDËRTESË			ARË			PA FRUTË			VLERA TOTALE (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Arë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Shtet			Tiranë	8320	11/434	Truall	1802.00	1802.00	0		11	46	323.2	22985	0.00										0	D- kjo pasuri është e okupuar nga Hysen Muzli Bardhi, ka një ndërtim pa leje.
2	Shtet			Tiranë	8320	11/521	Truall	334.00	334.00	0		22	89	107.7	22985	0.00										0.00	
3	Shtet			Tiranë	8320	11/432	Truall	693.00	693.00	0		11	44	94.6	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga ka dy ndërtime pa leje.
4	Shtet			Tiranë	8320	11/431	Truall	316.00	316.00	0.00		11	43	37.1	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Nuredin Halil Xhetani, ka një ndërtim pa leje
5	Shtet			Tiranë	8320	11/428	Truall	1338.00	1338.00	0.00		11	41	270.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Halil Nuredin Xhetani, ka dy ndërtime pa leje.
6	Shtet			Tiranë	8320	11/421	Truall	378.00	378.00	0.00		11	34	36.8	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Agron Ferit Bajramasi, ka dy ndërtime pa leje.
7	Shtet			Tiranë	8320	11/420	Truall	304.00	304.00	0.00		11	33	23.9	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Teki Ferit Bajramasi, ka dy ndërtime pa leje.
8	Shtet			Tiranë	8320	11/419	Truall	244.00	244.00	0.00		11	32	38.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Jordi Nazmi Pellumbi, ka tre ndërtime pa leje.
9	Shtet			Tiranë	8320	11/418	Truall	199.00	199.00	0.00		11	31	4.3	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Albert Nazmi Pellumbi, ka një ndërtim pa leje.
10	Shtet			Tiranë	8320	11/157	Truall	379.00	379.00	0.00		12	103	55.1	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga. z. Luan Qamil Lami, ka një ndërtim pa leje.
11	Shtet			Tiranë	8320	11/506	Rrugë	2573.00	0.00	0.00		17	165	987.5	22985	0										0	
12	Shtet			Tiranë	8320	3/1206	Rrugë	838.00	0.00	0.00		18	14	102.4	22985	0										0	
13	Shtet			Tiranë	8320	3/421	Truall	476.00	476.00	0.00		19	242	28.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Ramazan Bajram Stafa, ka një ndërtim pa leje.
14	Shtet			Tiranë	8320	3/420	Truall	610.00	610.00	0.00		19	241	16	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar, ka një ndërtim pa leje.
15	Shtet			Tiranë	8320	3/928	Truall	407.00	407.00	0.00		16	158	14	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Lulzim Hidajet Joca, ka një ndërtim të paligjshëm.
16	Shtet			Tiranë	8320	3/929	Truall	327.00	327.00	0.00		16	159	18.2	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga ka një ndërtim të paligjshëm.
17	Shtet			Tiranë	8320	3/930	Truall	441.00	441.00	0.00		16	160	43.7	22985	0										0	kjo Pasuri është e okupuar nga Besmir Selman Topuzi, ka një ndërtim të paligjshëm.
18	Shtet			Tiranë	8320	3/922	Truall	408.00	408.00	0.00		16	153	38.3	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga, ka një ndërtim të paligjshëm.
19	Shtet			Tiranë	8320	3/405	Rrugë	205.00	0.00	0.00		19	106	22	22985	0										0	
20	Shtet			Tiranë	8320	3/414	Truall	328.00	328.00	0.00		19	240	48	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Lulezim Shaban Bali, ka një ndërtim pa leje.
21	Shtet			Tiranë	8320	3/413	Truall	411.00	411.00	0.00		19	239	49.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Aqif Ismail Hoti, ka dy ndërtime të paligjshme.
22	Shtet			Tiranë	8320	3/1350	Rrugë	213.00	0.00	0.00		9	79	5.2	22985	0										0	
23	Shtet			Tiranë	8320	3/1100	Truall	250.00	250.00	0.00		4	175	39.4	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Vehbi Dyl Bala, ka një ndërtim pa leje.
24	Shtet			Tiranë	8320	3/915	Truall	309.00	309.00	0.00		16	147	56	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga dashamir Rifat Çajkri, ka dy ndërtime të paligjshme.
25	Shtet			Tiranë	8320	3/913	Truall	424.00	424.00	0.00		16	145	49	22985	0										0	kjo pasuri është e okupuar nga shkelqim hasan peposhi ka dy ndërtime të paligjshme.
26	Shtet			Tiranë	8320	3/912	Truall	574.00	574.00	0.00		16	144	9	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Petrit Ismail Mile, ka katër ndërtime të paligjshme.
27	Shtet			Tiranë	8320	3/899	Truall	406.00	406.00	0.00		16	134	289.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga
28	Shtet			Tiranë	8320	3/1306	Rrugë	348.00	0.00	0.00		4	184	17.7	22985	0										0	
29	Shtet			Tiranë	8320	3/894	Truall	302.00	302.00	0.00		16	129	5.2	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Shkelqim Ramazan Lami, ka një ndërtim të paligjshëm.
30	Shtet			Tiranë	8320	3/895	Truall	376.00	376.00	0.00		16	130	3.2	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga ka një ndërtim të paligjshëm.
31	Shtet			Tiranë	8320	3/896	Truall	387.00	387.00	0.00		16	131	343	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar.
32	Shtet			Tiranë	8320	3/891	Truall	232.00	232.00	0.00		16	126	50	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Selami Shahin Zeqollari, ka një ndërtim të paligjshëm.
33	Shtet			Tiranë	8320	3/890	Truall	163.00	163.00	0.00		16	125	61.3	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Gjergj Shahin Zeqollari, ka një ndërtim të paligjshëm.
34	Shtet			Tiranë	8320	3/365	Truall	450.00	450.00	0.00		19	226	128.7	22985	0										0	C- mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 3/365-nd., vol. 26, faqe 226, zona

																										kadastrale nr. 8320, vendim nr. 2923, datë 7.6.1994. GJRRGJ Tiranë. D- kjo pasuri është e okupuar nga Fatmir Dajka, ka dy ndërtime të jashtëligjshme
35	Shtet			Tiranë	8320	3/889	Truall	474.00	474.00	0.00		16	124	64.3	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Bedri Sulejman Vishkurti, ka një ndërtim të paligjshëm.
36	Shtet			Tiranë	8320	3/897	Truall	587.00	587.00	0.00		16	132	528.4	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar.
37	Shtet			Tiranë	8320	3/898	Truall	346.00	346.00	0.00		16	133	26.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Ramazan Adem Lacka, ka një ndërtim të paligjshëm.
38	Shtet			Tiranë	8320	3/866	Truall	305.00	305.00	0.00		16	102	16.1	22985	0										0	C- mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa me numër pasurie 3/866-nd., vol. 32 f. 246, ZK 8320. D- kjo pasuri është e okupuar nga Bashkim Vesel Suka, ka një ndërtim të paligjshëm.
39	Shtet			Tiranë	8320	3/865	Truall	307.00	307.00	0.00		16	101	16.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Vesel Haxhi Sulika, ka një ndërtim të paligjshëm.
40	Shtet			Tiranë	8320	3/864	Truall	204.00	204.00	0.00		16	100	54.2	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Shpetim Baki Vrioni, Ervin Shpetim Vrioni, ka dy ndërtime të paligjshme.
41	Shtet			Tiranë	8320	3/863	Truall	257.00	257.00	0.00		16	99	62.9	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Ergest Shpetim Vrioni, ka dy ndërtime të paligjshme.
42	Shtet			Tiranë	8320	3/359	Truall	390.00	390.00	0.00		19	225	105.3	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Kujtim Ismail Tafa, ka dy ndërtime të paligjshme.
43	Shtet			Tiranë	8320	3/862	Truall	190.00	190.00	0.00		16	98	116.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Bashkim Shaban Mucalla, ka një ndërtim të paligjshëm.
44	Shtet			Tiranë	8320	3/357	Truall	417.00	417.00	0.00		19	224	115.1	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Qamil Qordha, ka një ndërtim pa leje.
45	Shtet			Tiranë	8320	3/860	Truall	612.00	612.00	0.00		16	96	571.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga
46	Shtet			Tiranë	8320	3/859	Truall	120.00	120.00	0.00		2	212	8.2	22985	0										0	C- mbi këtë truall ndodhet ndërtesa 3/859-nd. vol. 4, faqe C189, në pronësi të Gezim Hoti. D- kjo pasuri është e okupuar nga. z. Gezim Halil Hoti.
47	Shtet			Tiranë	8320	3/1302	Rruge	961.40	0.00	0.00		4	139	12.8	22985	0										0	
48	Bashkia e Tiranës			Tiranë	8320	3/113	Truall	682.00	682.00	0.00		19	196	159.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Beqir Mustafa Hysenaj, ka tre ndërtime të paligjshme.
49	Shtet			Tiranë	8320	3/1334	Truall	476.00	476.00	0.00		4	214	357.3	22985	0										0	
50	Shtet			Tiranë	8320	3/1133	Truall	408.00	408.00	0.00		17	99	129.9	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga
51	Shtet			Tiranë	8320	3/1303	Rruge	746.00	0.00	0.00		4	140	23	22985	0										0	
52	Shtet			Tiranë	8320	3/1134	Truall	341.00	341.00	0.00		17	100	113.9	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Miranda Arben Mici.
53	Shtet			Tiranë	8320	3/1135	Truall	376.00	376.00	0.00		17	101	119.6	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Elias Arben Mici.
54	Shtet			Tiranë	8320	3/1136	Truall	414.00	414.00	0.00		17	102	127.5	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Andrian arben mici
55	Shtet			Tiranë	8320	3/1304	Rruge	1314.00	0.00	0.00		4	141	80.5	22985	0										0	
56	Shtet			Tiranë	8320	3/1210	Truall	316.00	316.00	0.00		17	169	21.3	22985	0										0	kjo pasuri është e okupuar nga gusim Kapo Senko, ka një ndërtim të paligjshëm.
57	Shtet			Tiranë	8320	3/1209	Truall	403.00	403.00	0.00		17	168	7.4	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga Ameli Kapo Senko.
58	Shtet			Tiranë	8320	3/1242	Truall	368.00	368.00	0.00		17	199	219.4	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga
59	Shtet			Tiranë	8320	3/1208	Truall	249.00	249.00	0.00		17	167	198.7	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga
60	Shtet			Tiranë	8320	3/1345	Rruge	1237.00	0.00	0.00		4	219	61	22985	0										0	
61	Shtet			Tiranë	8320	3/1347	Rruge	590.00	0.00	0.00		4	221	49.6	22985	0										0	
62	Shtet			Tiranë	8320	3/399	Rruge	860.00	0.00	0.00		19	107	847.6	22985	0										0	
63	Shtet			Tiranë	8320	3/1355	Truall	206.00	206.00	0.00		4	215	58	22985	0										0	
64	Shtet			Tiranë	8320	3/1352	Truall	2356.16	2356.16	0.00		21	46	873.5	22985	0										0	
65	Shtet			Tiranë	8320	11/491	Trotuare	388.00	0.00	0.00		12	134	25	22985	0										0	
66	Shtet			Tiranë	8320	11/413	Truall	584.00	584.00	0.00		11	26	1.1	22985	0										0	Kjo pasuri është e okupuar nga, ka dy ndërtime pa leje.
67	Shtet			Tiranë	8320	3/1346	Rruge	2296.00	0.00	0.00		4	220	7	22985	0										0	
68	Samir	Fatmir	Mane	Tiranë	8320	3/1615	Truall	4775.30	4775.30	0.00		33	78	24.8	0	0										0	D- bllokohet pasuria në favor të shoqërisë "Progreen" sh.p.k. K. sip. nr. 833/633, datë 23.2.2022, not. T.A. Mancka.
69	Samir	Fatmir	Mane	Tiranë	8320	3/1614	Truall	3662.70	3662.70	0.00		33	77	59.3	0	0										0	D- bllokohet pasuria në favor të shoqërisë "Progreen" sh.p.k. K. sip. nr. 833/633, datë 23.2.2022. Not. T.A. Mancka - kontratë sipërmarrje/akt marrëveshje ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit nr. 4105 rep. nr. 2187 kol. – kontratë sipërmarrje/akt marrëveshje ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit nr. 464/252.
70	Samir	Fatmir	Mane	Tiranë	8320	3/1511	Truall	3106.80	3106.80	0.00		28	10	69.3	0	0										0	
71	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1499	Truall	3420.00	3420.00	0.00		27	241	108.5	0	0										0	
72	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1526	Truall	3950.70	3950.70	0.00		28	46	251.3	0	0										0	C- regjistrohet vendimi nr. 3484, datë 13.12.2021, për miratimin e lejes së ndërtimit për "Godinë banimi 9-katëshe

																										+2-katëshe nën tokë, Bashkia Kamzë, vendimi nr. 3484, datë 13.12.2021 d- k. sipërmarrje (shtesë kontrate) 97/57, datë 10.1.2022, shtesë nr. 1, nr. 3149/2383, datë 12.8.2021, për zbatimin e godinës 1&2, godinës 3&4, godinës 5&6.
73	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1525	Truall	3773.50	3773.50	0.00		28	45	247.5	0	0										0	C- me vendimin nr. 4373, datë 25.10.2022, Bashkia Kamzë me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoq. Ales Construction sh.p.k., shkresë nr. 10516, datë 14.11.2022, Bashkia Kamzë. D- k. sipërmarrje (shtesë kontrate) 97/57, datë 10.1.2022, shtesë nr. 1, nr. 3149/2383, datë 12.8.2021, për zbatimin e godinës 1&2, godinës 3&4, godinës 5&6
74	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1524	Truall	3439.50	3439.50	0.00		28	44	235.8	0	0										0	C- me vendimin nr. 4399, datë 7.11.2022, të Bashkisë Kamzë me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoq. Ales Construction sh.p.k., shkresë nr. 247, datë 12.1.2022, Bashkia Kamzë. D- k. sipërmarrje (shtesë kontrate) 97/57, datë 10.1.2022.
75	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1497	Truall	8872.30	8872.30	0.00		27	225	519.3	0	0										0	
76	Samir	Fatmir	Mane	Tiranë	8320	3/1496	Truall	5903.00	5903.00	0.00		27	224	400.5	0	0										0	
77	Elite Urban Development			Tiranë	8320	3/1488	Truall	1432.00	1432.00	0.00		27	194	107.8	0	0										0	Regjistrohet certifikata e përdorimit nr. 4008/1 prot., datë 11.10.2022, për objektin "Godinë shërbimi 2-katëshe mbi tokë (porta hyrëse) – Bashkia Kamzë, shkresë nr. 9615, prot., datë 20.10.2022.
78	Samir	Fatmir	Mane	Tiranë	8320	3/1521	Truall	2451.30	2451.30	0.00		28	20	151.4	0	0										0	
	Total													**10772.6**			**0**			**0**						**.00**	
											DEGA B																
1	Shtet			Mëzez	2679	16/76	Arë	3078.00	0.00	0	3078	50	152	0	0	0.00	0	0	0	576.7	0	0				0	E- kartela e pasurisë së re u hap me ref. 00017722.58.
2	Shtet			Mëzez	2679	361/17	Arë	3490.00	0.00	0	3490	43	234	0	0	0.00	0	0	0	260.5	0	0				0	D- mbi këtë pasuri ndodhen 3 ndërtime, për të cilat nuk ka informacion apo dokumentacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017729.63.
3	Myftar	Rrahman	Beshiraj	Mëzez	2679	23/1	Arë	5000.00	0.00	0	5000	3	131	0	0	0.00	0	0	0	423.2	448	189593.6				189,593.60	C- pasuria u rivlerësua në vlerën prej 2,240,000 lekësh me aplik. nr. 11687, datë 20.1.2017, RVP. E- kartela u përmirësua me ref. 00017702.39.
4	Shtet			Mëzez	2679	23/16	Truall	1460.00	1460.00	0.00	0.00	30	112	248.9	0	0.00	0	0	0	0	0	0				0.00	D- mbi këtë pasuri janë pozicionuar 3 ndërtim, për të cilat nuk disponojmë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017700.36.
5	Hil Hile	Vas Çun	Zefi Zefi	Mëzez	2679	23/8	Arë	1000.00	0.00	0.00	1000.00	8	159	0	0	0.00	0	0	0	154.1	448	69036.8				69,036.80	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017701.37.
6	Shtet			Mëzez	2679	83	Pa frut	1400.00	0.00	0.00	0.00	4	133	0	0	0.00	0	0	0	0	0	0	52.6	0	0	0.00	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref .00017725. sip. në B2 është shënuar 434 m², sepse zona objekt kontrolli i është nënshtruar procesit pjesor të përmirësim/përditësimit 61.
7	Nevruz	Edip	Rustani	Mëzez	2679	24/12	Arë	400.00	0.00	0.00	400.00	9	4	0	0	0.00	0	0	0	48.3	448	21638.4				21,638.40	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017703.40.
8	Allaman	Edip	Rustani	Mëzez	2679	24/13	Truall	400.00	400.00	128.00	0.00	9	5	66.4	4242	281,668.80	0	0	0	0	0	0				281,668.80	E- leje legalizimi nr. 793, datë 25.3.2009, god. banimi 1-katëshe, sip. ndërt = 128 m², sip. tot. ban. = 128 m², sip. parc.= 400 m², sipas ref. 00005473. kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017704.41.
9	Iron	Ethem	Rustani	Mëzez	2679	24/14	Arë	375.00	0.00	0.00	375.00	9	6	0	0	0	0	0	0	101.4	448	45427.2				45,427.20	E- kartela u përmirësua/përditësua dhe u korrigjua me ref. 00017705.42.
10	Sokol	Vesel	Osmani	Mëzez	2679	24/15	Truall	330.00	330.00	81.00	0.00	9	7	81.9	4242	347,419.80	0	0	0	0	0	0				347,419.80	E- leje legalizimi nr. 83917, datë 13.6.2013, god. banimi 1-katëshe, sipas ref. 00007970, sip. parc.= 330 m², sip. kati përdhes = 81 m², sipas ref. 00007970, kartela u korrigjua/ përmirësua/përditësua me ref. 00017706.43.
11	Petrit Petrit	Arif Fuat	Osmani Osmani	Mëzez	2679	24/16	Arë	330.00	0.00	0.00	330.00	9	8	0	0	0	0	0	0	50.5	448	22624				22,624.00	E- kartela u përmirësua me ref.00017707.44.
12	Deli	Shaban	Krasniqi	Mëzez	2679	24/17	Arë	987.00	0.00	0.00	987.00	9	9	0	0	0	0	0	0	148.3	448	66438.4				66,438.40	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017708.45.
13	Shtet			Mëzez	2679	25/5	Pa frut	840.00	0.00	0.00	0.00	4	112	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7.7	0	0	0.00	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref .00017724. Sip. në B2 është shënuar 164 m², sepse zona objekt kontrolli i është nënshtruar procesit pjesor të përmirësim/përditësimit 60.
14	Dionis Dorian Ferit Genti Maliq Mynefe Natasha	Kujtim Neshet Bexhet Neshet Bexhet Bexhet Demir	Jazaj Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha	Mëzez	2679	25/14	Arë	7400.00	0.00	0.00	7400.00	9	92	0	0	0	0	0	0	460	448	206080				206,080.00	E- vijon dhe nga vol. 8, f. 38 dhe nga vol. 4, f. 111. me ref. 00017709, u ndryshuar numri i pasurisë nga 25/10 në 25/14. Kartela u korrigjua/ përmirësua/përditësua me ref. 00017709.46.
15	Shtet			Mëzez	2679	36/186	Kanal	630.00	0.00	0.00	0.00	50	204	33.1	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	Kartela u hap me ref.00017722.64.

16	Gjyle Hysen	Shahin Vath	Labi Labi	Mëzez	2679	36/23	Arë	126.00	0.00	0.00	126.00	10	141	0	0	0	0	0	0	42.1	448	18860.8				18,860.80	D- mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë për të cilën nuk disponojmë asnjë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017727.48.
17	Orinela Esteban Esterela Ahmet Rehana	Petrit Safet Safet Safet Safet	Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha	Mëzez	2679	36/24	Arë	128.00	0.00	0.00	128.00	10	142	0	0	0	0	0	0	42.3	448	18950.4				18,950.40	D- lirim nga ref. 00006738. Deklaratë noteriale nr. 3218 rep., nr. 1030 kol., datë 14.4.2021, mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtim për të cilin nuk disponojmë asnjë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017712.49.
18	Isuf	Dine	Berisha	Mëzez	2679	36/74	Are	100.00	0.00	0.00	100.00	12	19	0	0	0	0	0	0	31.2	448	13977.6				13,977.60	D- në favor të Fondi Besa sh.a., vl. 700.000 lekë, k. hip. 3789/1669, datë 5.8.2019 kontratë/deklaratë noteriale për vendosje hipoteke vendoset sekuestro konservative, me shkresën nr. 2596 prot., nr. 1122 dosje, datë 20.3.2023, përmbarues Jonida Ujkashi. Mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë për të cilën nuk kemi dokumentacion apo informacion. Kontratë nr. 3789 rep., nr. 1669 kol., datë 5.8.2019. E- kartela u përditësua me kërkesën nr. 9036, datë 5.11.2013. Kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017717.54.
19	Xhuver Hekuran	- Maliq	Muka Daci	Mëzez	2679	36/75	Arë	200.00	0.00	0.00	200.00	12	20	0	0	0	0	0	0	63.8	448	28582.4				28,582.40	D- mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë për të cilën nuk kemi asnjë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017718.55.
20	Bujar	Ali	Dervishi	Mëzez	2679	36/185	Arë	86.00	0.00	0.00	86.00	14	83	0	0	0	0	0	0	25.6	448	11468.8				11,468.80	E- me referencën 00017720 është ndryshuar numri i pasurisë nga 36/99 në 36/185. Kartela u korrigjua/përmirësua/përditësua me ref. 00017720.57.
21	Fran Vjollca	Pal Nikoll	Muça Muça	Mëzez	2679	36/98	Arë	660.00	0.00	0.00	660.00	14	82	0	0	0	0	0	0	218	448	97664				97,664.00	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017719.56.
22	Preng Martine	Gjok Gjin	Pjetri Pjetri	Mëzez	2679	36/148	Arë	200.00	0.00	0.00	200.00	31	102	0	0	0	0	0	0	52.9	448	23699.2				23,699.20	D- mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtim për të cilin nuk kemi asnjë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017714.51.
23	Gjin	Gjok	Pjetri	Mëzez	2679	36/149	Arë	300.00	0.00	0.00	300.00	31	103	0	0	0	0	0	0	80.3	448	35974.4				35,974.40	D- mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë për të cilën nuk kemi asnjë dokumentacion apo informacion. e- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017715.52.
24	Gjin	Gjok	Pjetri	Mëzez	2679	36/150	Arë	300.00	0.00	0.00	300.00	31	104	0	0	0	0	0	0	76.8	448	34406.4				34,406.40	E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017716.53.
25	Ferid	Marash	Prebibaj	Mëzez	2679	36/25	Arë	500.00	0.00	0.00	500.00	10	143	0	0	0	0	0	0	125	448	56000				56,000.00	D- kjo pasuri ndodhet mbi pasurinë 36/25 regjistruar në vol. 39, f. 23 leg. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017713.50.
26	Farie	Ramadan	Halilja	Mëzez	2679	36/18	Arë	400.00	0.00	0.00	400.00	9	183	0	0	0	0	0	0	100	448	44800				44,800.00	D- mbi këtë pasuri pozicionohet një ndërtim, për të cilin nuk kemi asnjë dokumentacion apo informacion. E- kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017710.47.
27	Shtet			Mëzez	2679	54/89	Truall	250.00	250.00	90.00	0.00	7	73	175.8	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	
28	Shtet			Mëzez	2679	54/64	Truall	250.00	250.00	90.00	0.00	7	35	59.2	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	
29	Shtet			Mëzez	2679	54/90	Truall	250.00	250.00	80.00	0.00	7	85	198	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	
30	Shtet			Mëzez	2679	54/91	Truall	250.00	250.00	90.00	0.00	7	87	175.8	0	0	90	0	0	0	0	0				0.00	C- mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 54/91-nd. vol. 33, f. 39, ZK 2679, l. leg. nr. 262107, datë 20.6.2016.
31	Shtet			Mëzez	2679	54/92	Truall	250.00	250.00	90.00	0.00	7	89	166	0	0	90	0	0	0	0	0				0.00	
32	Shtet			Mëzez	2679	54/93	Truall	250.00	250.00	80.00	0.00	7	91	7.1	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	
33	Shtet			Mëzez	2679	164/22	Rruge	4000.00	0.00	0.00	0.00	8	152	2068.8	0	0	0	0	0	0	0	0				0.00	
34	Shtet			Mëzez	2679	90	Pa frut	1400.00	0.00	0.00	0.00	4	140	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1230.36	0	0	0.00	
35	Pa informacion			Mëzez	2679	38/7								314.7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00	
36	Nico & Co shpk			Mëzez	2679	37/25	Are	3,000.00		817.60	3000.00	12	3	0	0	0	0	0	0	380.1	0	0	0	0	0	0.00	Godinë banimi dhe shërbimi 4–6-katëshe, me 1 kat parkim nëntokë, vijon nga vol. 34 f. 39 deri në vol. 34, f. 120.
37	Arben	Frrok	Ndreu	Mëzez	2679	37/26	Are	500.00	0.00	0.00	500.00	14	181	0	0	0	0	0	0	161.1	0	0	0	0	0	0.00	
38	Astrit	Fadil	Dervishi	Mëzez	2679	37/8	Are	2000.00	0.00	0.00	2000.00	1	215	0	0	0	0	0	0	217	0	0	0	0	0	0.00	
39	Suzana Renald Indrit Migena Myfit	Hajdar Myfit Myfit Myfit Dervish	Dervishi	Mëzez	2679	37/7	Are	2000.00	0.00	0.00	2000.00	1	214	0	0	0	0	0	0	251.8	0	0	0	0	0	0.00	Pas. vihet në dispozicion të shoq. "Benga SI 2006" sh.p.k., për ndërtim, k. sip. 2260/407, datë 1.3.2012.
40	Esat	Dervish	Dervishi	Mëzez	2679	37/6	Are	2000.00	0.00	0.00	2000.00	2	43	0	0	0	0	0	0	298	0	0	0	0	0	0.00	
	Total													**3346.8**			**180**			**2974.5**						**1,634,311.00**	

KËRKESË

Shtetasi Aldimir Jaupaj kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, shpalljen të zhdukur të nënës së tij, shtetases Tabeko Jaupaj, me atësi Rakip dhe amësi Bukuri, e datëlindjes 12.3.1964, lindur në Spathar, Përmet.

KËRKUES
Aldimir Jaupaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/09/29 15:05:00 +02'00'
2368fb419756464197df8e52b2f64cef2025092915
044931031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)